



**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS**

**I.Numër: 400/01-97931, dt: 30 Dhjetor 2024**

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit e Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarit privat z. Bashkim (Rustem) Tatari, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Pejës, në takimin e mbajtur më datë: 30 Dhjetor 2024, nxjerrë këtë:

**VENDIM  
Nr. 69/2024**

**Mbi Miratimin për Këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Bashkim (Rustem) Tatari me qëllim të përmbushjes së Interesit Publik: Rregullimin e shtratit të Lumbardhit dhe hapjen e shëtitorës.**

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për Këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim të përmbushjes së Interesi Publik: Rregullimi i shtratit të Lumbardhit dhe hapja e shëtitorës.
- II. Parcela kadastrale nr.6274-2 në sipërfaqe prej 58m<sup>2</sup> ZK Pejë pronë e pronarit Bashkim (Rustem) Tatari do të merret për nevoja të përmbushjes së Interesi Publik: Rregullimin e shtratit të Lumbardhit dhe hapjen e shëtitorës, dhe në të njëjtën kohë do të jetë objekt këmbimi me parcelën kadastrale nr. 2960-9 në sipërfaqe prej 56m<sup>2</sup> ZK Pejë pronë Komuna Pejë.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Vlerësimet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Tatimit në Pronë të aprovuara me datën 06.12.2024.  
*-Prona e Komunës, ngastra kadastrale nr.2960-9 në sipërfaqe prej 56 m<sup>2</sup> ZK Pejë është vlerësuar 450 €/m<sup>2</sup> që i bie totali 25,200.00 €.*  
*-Prona private e Bashkim (Rustem) Tatarit, ngastra kadastrale nr.6274-2 në sipërfaqe prej 58m<sup>2</sup> ZK Pejë është vlerësuar 450.00 €/m<sup>2</sup>, që i bie totali 26,100.00 €.*  
*-Ashtu që Komuna obligohet që Bashkim (Rustem) Tatarit t'ia kompenzoj diferencën në shumën prej 900.00 €.*
- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do t'i nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtorja për Çështje Pronësores–Juridike.
- VI. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në Web faqen e Komunës së Pejës.

**Vendimi ti dërgohet:**  
MAPL-së,  
Kryetarit të Komunës,  
DÇPJ,  
Arkiv.

